



**QENDRA PËR ZHVILLIM KOMUNITAR
"SOT PËR TË ARDHMEN"**

Rr. Leon Tolstoi, Durrës
Rr. e Elbasanit, Tiranë
Pranë Bashkisë Pukë, Pukë
Shqipëri
Tel/Fax: +355 230 2410
info@cdc-tff.org
www.cdc-tff.org

Rrjeti i reagimit kundër dhunës
Nr. i Gjelbër: 0800 98 88

**Situata krahasuese e dhunës në familje në Tiranë, Durrës,
Elbasan, Korçë, Burrel dhe Pukë për vitin 2013**

Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"

Tiranë, Prill 2014

Përgatitja e raportit u mundësua nga OSFA – Fondacioni "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", në kuadër të projektit "Të ecësh në Këpucët e Saj!" zbatuar nga Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"



**Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë
SOROS**

Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Fondacionit Soros

Hyrje

Në Shqipëri, dhuna në familje është një problem që ndikon negativisht tek individët, familjet dhe komunitetet. Është e rëndësishme të theksohet se dhuna në familje ndaj grave dhe fëmijëve nuk është një fenomen i ri në Shqipëri, por ajo ka rrënjë të thella kulturore në shoqëri.

Ajo, çka është dramatike, është rritja me shpejtësi e rasteve të dhunës, e frekuencës së ndodhjes, e formave të dhunës, si dhe e numrit të shkaqeve dhe pasojave të rasteve të dhunës. Në zonat rurale dhe lokale, si dhe në komunitete në nevojë, këto raste janë akoma më shumë tragjike.

Format e dhunës me bazë gjinore përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: dhuna në familje, abuzimi seksual, përdhunim, ngacmim seksual, trafikim të grave, prostitucion i detyruar, dhe praktikrat e dëmshme. Këto forma të dhunës mund të rezultojë në shëndetin fizik, mendor, seksual dhe riprodhues dhe probleme të tjera shëndetësore. Përveç kësaj faktorë të tillë si: rajoni, etnia, feja, mosha, seksualiteti, karriera profesionale dhe statusi shoqëror janë përdorur si shkaqe jo vetëm në ushtrimin e dhunës por edhe në rritjen dramatike të këtij fenomeni vrastar.

Projekti “Të ecësh në Këpucët e saj!” mbështetur nga Soros - Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë u zbatua gjatë periudhës Nëntor 2013 – Prill 2014, me fokus në *a) përmirësimin e reagimit qytetar mbi dhunën ndaj grave dhe në familje; b) përmirësimin e reagimit dhe shërbimit institucional ndaj rasteve të dhunës dhe parandalimit të dhunës nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të autoriteteve përkatëse shtetërore; c) edukimin e komuniteteve dhe medias nëpërmjet fushatave ndërgjegjëse dhe sensibilizuese të 16 ditëve kundër dhunës dhe ditës ndërkombëtare të gruas në qytetet Tiranë, Durrës, Pukë, Burrel, Elbasan dhe Korçë.*

Raporti mbi situatën krahasuese të dhunës në familje për vitin 2013 u hartua në bazë të të dhënave 2013 të Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Korçës, Burrelit dhe Pukës, dhe në bazë të gjetjeve nga takimet e zhvilluar me anëtarë të Rrjetit të Reagimit të Koordinuar kundër Dhunës në Familje në këto zona nën komponentin e projektit: *Ngritja e kapaciteteve në Bashkitë dhe Komunitat e targetuara për parandalimin e rasteve të dhunës si dhe për përmirësimin e shërbimit të trajtimit të rasteve të raportuara.*

Përmbajtja

Mekanizmi i bashkërendimit të Punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare	3
<i>Gjetje dhe Përfundime mbi RrRKDh:</i>	4
<i>Rekomandime:</i>	5
Niveli i denoncimeve të dhunës në familje për vitin 2013 në Tiranë, Durrës, Korçë, Elbasan, Burrel dhe Pukë.	6
<i>Gjetje dhe Përfundime:</i>	7
<i>Rekomandime:</i>	7
Rastet e Urdhër Mbrojtjeje të Menjëhershme dhe Urdhër Mbrojtje për vitin 2013 në Tiranë, Durrës, Korçë, Elbasan, Burrel dhe Pukë.	8
<i>Gjetje dhe Përfundime:</i>	9
<i>Rekomandime:</i>	9
Portretizimi i rasteve të dhunës në familje.....	10
<i>Gjetje dhe Përfundime:</i>	11
<i>Rekomandime:</i>	11

Mekanizmi i bashkërendimit të Punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare

Në vitin 2006, parlamenti shqiptar miratoi ligjin e parë për dhunën në familje në Shqipëri. Baza ligjore për adresimin e dhunës është Ligji “Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” Nr.9669, datë 18.12.2006. Miratimi dhe hyrja në fuqi e këtij ligji në 2006 dhe amendimeve të tij më 2007 dhe më tej më 2010 është një hap i rëndësishëm drejt plotësimit të kuadrit ligjor në fushën e dhunës në familje. Qëllimi i këtij ligji është të parandalojë dhe pakësojë dhunën në familje në të gjitha format e saj me anë të masave të përshtatshme ligjore, si dhe të garantojë mbrojtjen me mjete ligjore të anëtarëve të familjes që janë objekt i dhunës në familje. Ligji ka katër objektiva kryesore:

1. Të krijojë një rrjet të bashkërenduar të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, dhe për zbutjen e pasojave të dhunës në familje dhe parandalimin e saj;
2. Të drejtojë përpjekjet për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
3. Të fuqizojë kompetencat e organeve gjyqësore në marrjen e masave mbrojtëse kundër dhunës në familje;
4. Të sigurojë/garantojë që viktimave të dhunës t’u ofrohen shërbime të shpejta, jo të kushtueshme, dhe të thjeshta nga gjykatat dhe organet e tjera ligj-zbatuese në përputhje me ligjin.

Ligji “Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” organizon gjashtë institucione qeveritare në një rrjet të bashkërenduar autoritetesh për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, zbutjen e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje. Autoriteti drejtues sipas këtij ligji është MMSR. Autoritete të tjera përgjegjëse janë Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe njësitë e qeverisjes vendore. Në vitin 2011, në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 8/8 të ligjit “Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (ndryshuar në vitin 2010), Këshilli i Ministrave vendosi krijimin e “Mekanizmit të bashkërendimit për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. Në bazë të këtij vendimi u krijuan komitete drejtuese përgjegjëse për bashkërendimin e veprimit të organeve kompetente përgjegjëse në nivel vendor dhe për referimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe u përcaktuan përgjegjësitë e ekipeve teknike ndër-dikasteriale dhe të bashkërenduesve vendore për referimin e rasteve të dhunës në kushtet e familjes.

Disa nga funksionet e zyrës për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje:

1. Identifikimi i viktimave të dhunës në familje;
2. Mbështetje dhe asistencë e monitoruar, ofruar në bazë të nevojave individuale të viktimës;
3. Referimi i rasteve tek anëtarët e reagimit të koordinuar, në varësi të nevojave të identifikuar;
4. Organizimi i takimeve periodike me anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
5. Aktivitete ndërgjegjësuere në lidhje me fenomenin e dhunës në familje;
6. Monitorimi dhe mbështetje e integritetit të çështjeve të Barazisë Gjinore në të gjitha planet, aktivitetet dhe vendimet e bashkisë.

Gjetje dhe Përfundime mbi RrRKDh:

- Mungesa/Përfundimi i mbështetjes financiare të RrRKDh. *(Tirana, Korça dhe Burreli janë në përfundim të mbështetjes financiare nga PNUD dhe nuk janë përfshirë në buxhetin e Bashkisë. Në Pukë ka përfunduar mbështetja financiare (UN Trust Fund) prej dy vitesh dhe Zyra për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në familje po punon në baza vullnetare. Në Durrës shënohet një hap pozitiv sepse është përfshirë në buxhetin e Bashkisë mbështetja për RrRKDh.)*
- Takimet me anëtarët e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ETN) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje organizohen në mënyrë periodike, por nuk janë të përfshirë në mënyrë aktive/ose nuk marrin pjesë të gjithë aktorët. Jo të gjithë antarët e Rrjetit të Reagimit të Koordinuar i zbatojnë detyrimet dhe përgjegjësitë që ligji u ka sanksionuar për t'ju përgjigjur si duhet dhe në kohë viktimave të dhunës në familje.
- Në pjesën më të madhe të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje, institucioni i parë pritës i viktimave është policia.
- Përfaqësuesi/ja e secilit institucion, pjesë e ETN-së që kontaktohet nga viktimat, duhet të njoftojë Koordinatorin Vendore, gjë që nuk ndodh gjithmonë. Kjo sjell edhe një mungesë të të dhënave të sakta për viktimat e dhunës në familje për secilin qark/qytet. Zakonisht policia disponon shifra më të larta të rasteve të dhunës në familje në krahasim me Zyrën për Barazi Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje.
- Të dhënat statistikore përqëndrohen në profilizimin e viktimës së dhunës në familje, ndërkohë që del e nevojshme gjithashtu profilizimi i dhunuesit.
- Strehimi i rasteve emergjente të viktimave të dhunës në familje mbetet një problem i pazgjidhur. Viktimat e dhunës në familje, që kanë denoncuar për dhunë në familje dhe janë në pritje të UMM/UM, nuk mund të strehohen në Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Dhunës në Familje dhe në strehëzat e tjera të ofruara nga OJF-të.
- Viktimave të dhunës në familje me UMM/UM përfitojnë një ndihmë ekonomike prej 3000 lekësh. Shfaqen shumë pengesa për përfitimin e kësaj ndihme, duke filluar që nga dokumentacioni i shumtë që kërkohet.

Rekomandime:

- Një nga masat më të rëndësishme për të parandaluar dhe luftuar dhunën në marrëdhëniet familjare është bashkëpunimi i qeverisë qendrore dhe vendore me organizatat e shoqërisë civile. Është e rëndësishme dhe e nevojshme siguri i mbështetjes së vazhdueshme financiare të rrjetit të reagimit të koordinuar kundër dhunës në familje të ngritur nëpër bashki, si dhe zgjerimi i tij nëpër komuna ku nuk ekziston.
- Gjithashtu ndërgjegjësimi dhe trajnimi mbi dhunën në marrëdhëniet familjare duhet të jetë i vazhdueshëm me të gjithë institucionet-pjesë të Rrjetit të reagimit të koordinuar kundër dhunës në familje, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të secilit prej tyre duke ofruar një mbështetje sa më të plotë dhe efektive viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.
- Proçesi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i monitorimit dhe i mbledhjes së të dhënave nga të gjithë aktorët e Rrjetit të reagimit të koordinuar në bashkëpunim me koordinatorin vendor pranë zyrave për barazi gjinore dhe kundër dhunës në familje është mjaft i rëndësishëm për të na siguruar një panoramë të qartë të prevalencës dhe incidencës së dhunës në marrëdhëniet familjare për çdo rreth të Shqipërisë.
- Për këtë qëllim, del e nevojshme dhe mbledhja e të dhënave edhe mbi dhunuesit, për të bërë një profilizim të burimit të dhunës, në mënyrë që të nxitet dhe zgjerohet këndvështrimi i masave për parandalimin e dhunës nëpërmjet edukimit.
- Një masë tjetër e rëndësishme është ngritja e strehëzave emergjence për viktimat e dhunës në familje, në rastet kur atyre iu duhet të presin 48 orë për Urdhërin e Menjëhershëm të Mbrojtjes ose Urdhërin e Mbrojtjes. Viktima dhe dhunuesi në shumë raste ndajnë të njëjtën banesë, pasi nuk ka strehëza apo vende të tjera alternative ku mund të qëndrojnë viktimat. Ndarja e të njëjtës banesë me dhunuesin rrit rrezikun për sigurinë fizike dhe mendore të viktimës. Mbështetja sociale, ndihma financiare dhe jofinanciare, si dhe mundësitë për strehim social për ato viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare që lenë strehëzat, janë masat e nevojshme për t'i ndihmuar ato që të rehabilitohen dhe të nisin një jetë të re.

Niveli i denoncimeve të dhunës në familje për vitin 2013 në Tiranë, Durrës, Korçë, Elbasan, Burrel dhe Pukë.

Nga të dhënat e marra për Qarqet Tiranë, Durrës, Korçë, Elbasan dhe Bashkitë Pukë dhe Burrel, rezultojnë se gjatë vitit 2013 numri i denoncimeve të raportuara për dhunë në familje është 2.090, të cilat janë përmbledhur në *Tabela 1 "Numri i Denoncimeve për dhunë në familje gjatë vitit 2013"*.

Vihet re se numri më i madh i denoncimeve ka ndodhur në qarqet Tiranë (48.6%), Durrës (23.5%) dhe Korçë (13.7%).


Qarku/Bashkia	Numri i denoncimeve për dhunë në familje
Tiranë	1,015
Durrës	492
Korçë	287
Elbasan	223
Burrel	50
Pukë	23
TOTAL 2013	2,090

Tabela 1. Numri i Denoncimeve për dhunë në familje gjatë vitit 2013.

Gjithashtu, në rend krahasues, vihet re se shpërndarja e denoncimeve për dhunë në familje është më e lartë në Durrës, dhe më e ulët në Elbasan, e krahasuar me shpërndarjen e popullsisë respektive.

Qarku/Bashkia	Shpërndarja e popullsisë sipas Qarkut/Bashkisë	Shpërndarja e nr. të denoncimeve për dhunë në familje sipas Qarkut/Bashkisë
Tiranë	48.1%	48.6%
Durrës	16.7%	23.5%
Korçë	13.6%	13.7%
Elbasan	18.4%	10.7%
Burrel	1.1%	2.4%
Pukë	2.1%	1.1%

Tabela 2. Shpërndarja e nr. të denoncimeve krahasuar me shpërndarjen e popullsisë sipas qarqeve/bashkive



Grafiku në krah tregon shpërndarjen e numrit të denoncimeve për dhunë sipas qarqeve/bashkive duke treguar gjithashtu dhe përqendrimin e popullsisë në këto qarqe/bashki.

Gjetje dhe Përfundime:

- Rrjeti i Reagimit të Koordinuar kundër Dhunës në Familje mbulon 5 nga 6 zonat në analizë. Sipas organeve përkatëse (Zyra e Barazisë Gjinore pranë Bashkive dhe Policia) niveli i denoncimeve është më i lartë për vitin 2013 krahasuar me vitet paraardhëse.
- Niveli i aksesit për marrjen e të dhënave dhe cilësia e informacionit nuk është i njëjtë në zonat e targetuara. Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Korça kanë informacion dhe të dhëna statistikore të përpunuara, kurse bashkitë Pukë dhe Burrel, paraqesin probleme në prezantimin e unifikuar të të dhënave statistikore. Duhet theksuar se Puka nuk është në rrjetin e Reagimit të Koordinuar kundër Dhunës në Familje.
- Për vitin 2013, të dhënat krahasimore të marra nga 6 zonat e targetuara tregojnë se numri i denoncimeve është më i lartë në zonat me popullsi jo vetëm më të madhe, por dhe subjekt i lëvizjes migratore si Tirana dhe Durrësi.
- Nga ana tjetër, numri i denoncimeve të rasteve të dhunës është i lidhur dhe me ndërgjegjësimin e viktimave për të kallëzuar dhe adresuar dhunën. Duke u bazuar në faktin se jo të gjitha rastet e dhunës në familje janë subjekt i denoncimit, në rrethet e vogla, mentaliteti më i ngurtë ndikon në mosraportim të rasteve të dhunës në familje.

Rekomandime:

- Rrjeti i Reagimit të Koordinuar kundër Dhunës në Familje në zonat ku është i vendosur duhet të koordinohet nëpërmjet zyrave të barazisë gjinore për të shkëmbyer dhe aksesuar informacionin mbi rastet e dhunës në familje. Për këtë gjë është e nevojshme që të ketë unifikim të të dhënave, terminologjisë, strukturës dhe aksesit të informacionit si dhe vendosja e periudhave kohore të raportuara dhe shtim i profilizimit të dhunuesit.
- Gjithashtu del e nevojshme, shtimi i përpjekjeve nga organet përkatëse si dhe rritja e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve në raportimin dhe denoncimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe për të mundësuar adresimin më të mirë të tyre.

Rastet e Urdhër Mbrojtjeje të Menjëhershme dhe Urdhër Mbrojtje për vitin 2013 në Tiranë, Durrës, Korçë, Elbasan, Burrel dhe Pukë.

Nga të dhënat e marra për qarqet Tiranë, Durrës, Korçë, Elbasan, dhe bashkitë Pukë dhe Burrel, rezulton se gjatë vitit 2013 numri i kërkesave për urdhër mbrojtjeje të menjëhershme dhe urdhër mbrojtje është në total 1.371, të përmbledhur në *Tabela 3 "Kërkesa për UMM/UM gjatë vitit 2013"*.

Vihet re se numri më i madh i denoncimeve ka ndodhur në rrethet Tiranë (48.5%), Durrës (28.2%) dhe Korçë (15.6%).

Rrethi	Kërkesë padi për UMM/UM
Tiranë	665
Durrës	387
Korçë	214
Elbasan	89
Burrel	15
Pukë	1
Gjithsej	1,371

Tabela 3. Kërkesa për UMM/UM gjatë vitit 2013.

Gjithashtu, u bë renditja dhe krahasimi i shpërndarjes së kërkesave për urdhër mbrojtjeje të menjëhershme dhe urdhër mbrojtje me shpërndarjen e denoncimeve për dhunë në familje. Vihet re se numri i kërkesave për UMM dhe UM është në të njëjtën ritëm me me numrin e denoncimeve, pra


qarqet/bashkitë me numrin më të lartë të denoncimeve kanë dhe numrin më të lartë të kërkesave dhe rrjedhimisht procedimeve të UMM dhe UM.

Rrethi	UMM/UM vs. nr Denoncimeve	Kërkesë padi për UMM/UM	Numri i denoncimeve për dhunë në familje
Tiranë	66%	665	1015
Durrës	79%	387	492
Korçë	75%	214	287
Elbasan	40%	89	223
Burrel	30%	15	50
Pukë	4%	1	23

Tabela 4. Krahasimi UMM/UM me numrin e denoncimeve

Gjithashtu vihet re se qarqet Durrës dhe Korçë kanë përqindjen më të lartë të kërkesave për UMM dhe UM krahasuar me numrin e denoncimeve.

Kërkesat për UMM/UM përveç lidhjes së ngushtë me natyrën e dhunës së denoncuar, pasqyrojnë dhe nivelin e adresimit të denoncimit, koordinimin mes anëtarëve të rrjetit të reagimit të koordinuar dhe nivelin e shërbimeve të ofruara nga njëra anë si dhe ndërgjegjësimin e viktimave për të kërkuar shërbimet përkatëse.



Gjetje dhe Përfundime:

- Anëtarët e Rrjeti të Reagimit të Koordinuar kundër Dhunës në Familje kanë role dhe përgjegjësi të caktuara. Anëtarë të mekanizmit përveç institucioneve si Bashkitë, Policinë, Gjykatat, Zyrat e përmbarimit, Spitale etj., janë dhe strehëzat dhe shërbimet psikologjike dhe juridike për viktimat. Jo në të gjitha rrethet ka strehëza shtetërore dhe përgjithësisht strehimi i viktimave të dhunës në familje dhe shërbimet psikologjike dhe juridike ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat sipas rastit janë ose jo anëtarë të rrjetit të reagimit të koordinuar.
- Kërkesat për UMM dhe UM kanë lidhje dhe me shërbimet që i ofrohen viktimës në rast të tillë. Jo në të gjitha rastet viktimat kanë mundësinë e strehimit të menjëhershëm. Ekziston një hendek midis faktit që strehëzat shtetërore nuk ofrojnë strehim të menjëhershëm pa marrjen e urdhër mbrojtjes dhe rasteve të dhunës ekstreme ku del e domosdoshme që viktima të strehohet menjëherë para marrjes së urdhër mbrojtjes së menjëhershme. Ndërkohë që organizatat e shoqërisë civile që merren me dhënien e këtyre shërbimeve nuk i kanë kapacitetet e mjaftueshme për të realizuar strehimin e menjëhershëm.

Rekomandime:

- Për adresim sa më të mirë të rasteve të dhunës në familje është e domosdoshme rritja e bashkëpunimit dhe e cilësisë së tij mes organeve kompetente dhe pushtetit vendor nga njëra anë dhe organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë drejtim.
- Organizatat e shoqërisë civile kanë nivel më të lartë fleksibiliteti në dhënien e shërbimeve të strehimit, psikologjike dhe juridike ndaj viktimave të dhunës në familje se sa institucionet shtetërore dhe publike, por ndërkohë kanë dhe limite në kapacitetet e tyre financiare. Ndaj bashkëpunimi dhe koordinimi me organizatat jofitimprurëse duhet parë në shfrytëzimin e pikave të forta për të mundësuar një bashkëveprim efektiv dhe të menjëhershëm në të mirë të viktimave të dhunës.
- Për këtë arsye, për shërbime të cilat institucionet vendore nuk kanë fleksibilitetin për t'i ofruar, rekomandohet kontraktimi i tyre, si shërbimet e telefonisë falas (nr. gjelbër), shërbimet psikologjike dhe juridike, dhe strehimi në rastet e urdhrave të mbrojtjes së menjëhershme.
- Gjithashtu rekomandohet shkëmbimi i eksperiencës mes rrjeteve të reagimit të koordinuar mbi specifikat e trajtimit të rasteve të ndryshme dhe nxjerrjen e praktikave më të mira.
- Së fundmi, rekomandohet një buxhetim më i mirë gjinor në bashkitë respektive.

Portretizimi i rasteve të dhunës në familje

Të krahasuara të dhënat e rasteve të dhunës për vitin 2013 na dhanë këto elemente portretizimi: në më të shumtën e rasteve, viktimat është femër (71%), bashkëshorte (49%), dhe me arsim të ulët apo të mesëm.

Personat e dëmtuar	Përqindja e rasteve
Bashkëshortja	49%
Bashkëshorti	4%
Motra	2%
Vëllai	4%
Fëmija	7%
Prindi	14%
Të tjerë	20%
Femra	71%

Tabela 5

Siç shihet nga tabela 5, në 49% të rasteve viktimat e dhunës në familje është bashkëshortja.

Siç shihet nga tabela 6, në 74% të rasteve të dhunës në familje, viktimat është i/e martuar.

Personat e dëmtuar	Përqindja e rasteve
Beqar	7%
Martuar	74%
Divorcuar	12%
Bashkëjetesë	5%
I/e ve	1%
Të tjerë	1%

Tabela 6

Arsimi	Përqindja e rasteve
Pa arsim	3%
Fillor	6%
9 vjeçar	49%
I mesëm	27%
I lartë	15%

Tabela 7

49% e viktimave të dhunës kanë arsimin 9 vjeçar dhe 27% kanë arsim të mesëm.

Gjetje dhe Përfundime:

- Nga gjetjet e krahasimit të të dhënave për 2013 në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Burrel dhe Pukë, në shumicën e rasteve dhuna ushtrohet ndaj grave. Portreti i viktimave në shumicën e rasteve është femër, e martuar dhe me arsim të ulët / të mesëm. Grup tjetër viktimash të dhunës janë prindërit (femër/mashkull) dhe fëmijët. Këto të dhëna tregojnë se përqëndrimi më i madh i rasteve të dhunës mbetet brenda familjes e karakterizuar nga disa kurora martesore, dhe/ose e madhe në numër, me arsim të ulët, dhe probleme ekonomike dhe sociale. Ndërkohë, mungojnë të dhënat për të bërë dhe profilizimin e dhunuesit.

Rekomandime:

- Një nga avantazhet e organizatave të shoqërisë civile ndaj institucioneve shtetërore dhe publike përkatëse është ofrimi i shërbimeve multidisiplinare dhe fleksibël në lidhje me viktimat e dhunës në familje (shërbimi i telefonisë 24 orëshe pa pagesë për denoncimin e rasteve të dhunës, shërbimin psikosocial nëpërmjet telefonit dhe ballë për ballë, këshillim dhe trajtim psikosocial dhe juridik, mbështetje dhe përfaqësim të viktimave në gjykatë, prokurori etj.) Rekomandohet përdorim më i madh i këtij avantazhi si dhe bashkëpunim më i madh dhe intensiv ndërmjet organeve kompetente dhe pushtetit vendor me organizatat partnere në ndërmarrjen e fushatave të përbashkëta të ndërgjegjësimit.
- Nga ana tjetër, rekomandohet të integrohet dhe të përhapet edukimi dhe këshillimi psikosocial dhe juridik në çift/familje/grup, duke futur në skemën e këshillimit dhe trajtimit jo vetëm viktimën, por edhe dhunuesin aty ku është e mundur, duke synuar mospërsëritjen e dhunës dhe edukimin në familje. Për këtë arsye nevojitet mbledhja dhe analizimi i të dhënave dhe për dhunuesit për të patur një profilizim dhe të burimit të dhunës në familje.
- Gjithashtu, duhet iniciuar dhe zhvilluar seminare edukimi dhe ndërgjegjësimi me djemtë dhe burrat për rolin e tyre brenda familjes në respektimin e të drejtave të anëtarëve të familjes. Është e rëndësishme të përfshihen burrat dhe djemtë në krijimin e partneritetit gjinor dhe parandalimin e dhunës në familje. Burrat dhe djemtë duhet të aktivizohen që të jenë pjesë e sipërmarrjes së madhe të aksioneve kundër dhunës në familje.